

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqipëria hap Konsullatë Nderi në Napoli, Rama: Italia është 'alter egoja' jonë europiane, ne jemi napolit anët e anës tjetër të detit - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/shqiperia-hap-konsullate-nderi-ne-napoli-rama-italia-eshte-alter-egoja-jone-europiane-ne-jemi-napolitanet-e-anes-tjeter-te-detit/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 06:56:25 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 06:55:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	be384361c87e3c9fef0fbb514b66b577429402d2f682e1730dd64a1987625ed1
TEKSTI	9d65d80e9e8165d9de26989f9fe93b447aaa8a7f73bcadd6633d8d5373e834b6
PAMJA	e08b603534715d79956042fa0ccb179aa8524cbecabfc398e2a6695c8f7b87ca

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a2418055fda1fc53817b0e84cb807cc1a277f39562ffee4d5f49ef7955def97c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	41c8867184070196f446ef02a676766cc2aca397aa3ee03de1cf45e9c1c94b04
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a2418055fda1fc53817b0e84cb807cc1a277f39562ffee4d5f49ef7955def97c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: [Home](#) » [Shqipëria hap Konsullatë Nderi në Napoli, Rama: Italia është 'alter egoja' jonë europiane, ne jemi napolitanët e anës tjetër të detit](#)

KRYESORE

Demo

Shqipëria hap Konsullatë Nderi në Napoli, Rama: Italia është 'alter egoja' jonë europiane, ne jemi napolitanët e anës tjetër të detit

SEPTEMBER 16, 2026



Shqipëria ka tashmë një Konsullatë Nderi në Napoli, e cila do të drejtohet nga konsulli i nderit Giuseppe Lettieri. Me juridiksion në të gjithë rajonin e Kampanjës, ajo do të shërbejë si pikë referimi për komunitetin shqiptar që jeton në këtë zonë.

Në ceremoninë e inaugurimit mori pjesë edhe kryeministri Edi Rama, i cili tha se hapja e konsullatës krijon një urë të re mes Shqipërisë dhe Italisë.

"Sot jemi këtu jo për të hapur një konsullatë në kuptimin e ngushtë të fjalës, por për të hapur një derë mes dy realiteteve që historikisht kanë qenë shumë pranë dhe që, njerëzisht, janë shumë, shumë të ngjashme", u shpreh Rama.

Duke folur për marrëdhëniet mes dy vendeve, Rama tha se Italia nuk është thjesht një nga partnerët kryesorë të Shqipërisë, por e cilësoi atë si "alter egon europiane" të vendit tonë.

"Mes Shqipërisë dhe Italisë ekziston tashmë një partneritet strategjik, solid dhe i thellë, por unë e urrej kur më shkruajnë në fjalimet e mia se Italia është një nga partnerët tanë kryesorë ekonomikë, politikë dhe europianë, sepse kjo vlen për shumë vende të tjera. Italia nuk është ajo. Italia është alter egoja jonë europiane. Dhe Napoli është pasqyra jonë nga kjo anë e detit, sepse ne jemi napolitanët e anës tjetër dhe jemi krenarë që jemi të tillë dhe nuk duam të bëhemi milanezë, për të thënë", tha Rama.

Me nota humori, Rama tha se ndonëse nuk po shpallet "Republika Shqiptare e Napolit", tashmë në qytetin italian është hapur një derë ku flamuri shqiptar qëndron përkrah atij italian.

"Unë jam këtu shumë i lumtur që po e jetoj këtë moment gëzimi, këtë moment ku, edhe pse nuk po, le të themi, shpallim Republikën Shqiptare të Napolit, por gjithsesi kemi hapur së bashku një derë ku është flamuri i Shqipërisë dhe unë jam gjithmonë i lumtur kur e shoh pranë flamurit italian", tha Rama.

Konsullata pritet të ndihmojë në ofrimin e shërbimeve për shqiptarët në Kampanjë, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ekonomik, kulturor dhe social ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë.

[Edi Rama](#) [hap Konsullatë Nderi](#) [Kryeministër](#) [Napoli](#) [Shqipëria](#)

SHARE.

Postimet e reja

Shqipëria hap Konsullatë Nderi në Napoli, Rama:...

SEPTEMBER 16, 2026

Rama udhëton drejt SHBA-ve më 20 shtator,...

SEPTEMBER 15, 2026

Vdekja e Giorgos Mazonakis, misteri i foto...

SEPTEMBER 15, 2026

Aktori i njohur "Home alone" përlotet në Emm...

SEPTEMBER 15, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematikët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu